DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-1370/2
-VI-
Data Datum Date 06.12.2018

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Srdjan Popoviq, Kryetar i Komunës së Graqanicës<br>Lubisa Karadzic, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Graqanicës | |
| Cc: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunën e Graqanicës | |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Venera Çerkini U.D. Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL | Datë: 04/12/2018 020-1370 |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të komunës së Graqanicës | |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi nr.9392/18 për fillimin e procedurës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër |
| I miratuar më datë: 29.11.2018 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.11.2018 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural <u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosova
Qeveria e Kosovës Vlada Kosova Government of Kosova
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-1370/2
-VI-
Data Datum Date 06.12.2018

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Srđan Popović, gradonačelnik opštine Gračanica<br>Ljubiša Karadžić, predsedavajući Skupštine opštine Gračanica | |
| Kopija | Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinica za administraciju dokumenata u opštini Gra | |
| Preko: | Ivan Todosijević, ministar MALS-a,<br>Rozafa Ukimeraj, generalni sekretar MALS-a, | |
| Od: | Venera Çerkini v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS | Datum: 04/12/2018 020-1370 |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Gračanica | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovana predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br. 03/L-05 o lokalnoj samoupravi:

| |
|---|
| Odluka br.9392/18 o pokretanju postupka za davanje na kratkoročno korišćenje nepokretne opštinske imovine |
| Usvojena dana: 29.11.2018 |
| Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 30.11.2018 |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog akta opštine, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog gledišta *u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi*. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

**ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА**
**KOMUNA E GRAÇANICËS**
**MUNICIPALITY OF GRACANICA**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 7 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.35/2012), nenit 5 paragrafi 1 te Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dhjetë të rregullt, e mbajtur më datën 29.11.2018, nxjerr këtë:

**VENDIM Nr.71/2018/KG PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR**

**Neni 1**

Aprovohet fillimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë të hapësirës-sallës afariste në Llapllasellë, me sipërfaqe bruto totale prej 963 m², e cila gjendet në parcelat kadastrale nr. 338/1 dhe 338/2 ZK Llapllasellë.

**Neni 2**

Hapësira afariste nga paragrafi 1 i këtij Vendimi jepet në shfrytëzim afatshkurtër, për një periudhë kohore deri në 15 vite, me qëllim të fillimit të aktivitetit përkatës ekonomik dhe hapjes së vendeve të reja të punës.

**Neni 3**

Çmimi fillestar i qirasë së hapësirës afariste nga paragrafi 1 i këtij Vendimi do të përcaktohet në përputhje me dispozitat e aplikueshme të Rregullores mbi taksat, tarifat dhe gjobat komunale dhe aktet e tjera të Kuvendit të Komunës së Graçanicës.

**Neni 4**

Procedura e dhënies së pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër do të bëhet përmes procedurës së ankandit publik, e cila do të zbatohet nga Komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.35/2012) dhe Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës.

**Neni 5**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi pushon të vlejë Vendimi për dhënien e hapësirës afariste në shfrytëzim nr.7951/16 nga 05.12.2016.

**Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit**

Ljubiša Karadžić